



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 2924 Prot.

Fier, më 26/07/2022

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i Sekuestros)

PREFEKTIT TË QARKUT - FIER

Duke vlerësuar me kënaqësi bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve tona, në bashkërendimin e veprimeve për zgjidhjen e problemeve të dyanëshme, si dhe me synimin e përmbushjes së misionëve tona të ngarkuara nga Ligji. e shohim të domosdoshëm forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, pasi nga ana jonë konstatohet se në shume raste nëpërmjet Tij, është mundësuar shlyerja e borxhit doganor.

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", neni 48/4 i Tij "Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve" - *"Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre"*, në zbatim të Ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile", neni 131 i Tij *"Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale..."*, nenit 162/2 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" - *"Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet"*, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të

papaguara doganore dhe të akcizës”, pika VI.3.b e Tij, “Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar, njoftimi mund të bëhet edhe përmes lajmërimit publik. Këto njoftime do të vihen në stendën e krijuar posaçërisht për njoftim....si dhe në vende publike si në Bashki, Njësi Administrative, në gazetën e pushtetit vendor, në internet dhe me mjete të tjera audiovizive etj. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore, subjekti debitor konsiderohet i njoftuar.....”. kërkojmë nga ana Juaj :

• “Shpalljen Publike” për një periudhë kohore jo më pak se 30 (Tridhjetë) ditë të aktit administrativ – Vendimi i rikuperimit me forcë të detyrimeve doganore (bashkëngjitur), si vijon:

• Nr.2216 Prot., datë 17.04.2019, i materializuar për subjektin “Griselda Bilbil Asllanaj”, e lindur më 27.08.1987 në Ballsh – Fier dhe banuese në Fier (Ajet Gerguri, Nd.3, H.16).

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes aktit të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR
Arlind Lagji





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANES FIER

Nr. 2216 prot.

Fier, më 17.04.2019

VENDIM

Nr.76 date 08.04.2019

**Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor të subjektit
debitorit : " Griselda Rushanaj" me ID I75827074M**

Dega e Doganes Fier, me vendimin e nr. 89 date 25.06.2018 ka vendosur per personin fizik "Griselda Rushanaj" me ID I75827074M te shpallet debitor per shumen 24,700 lek ne forme detyrimi doganor, dhe kamat vonesat perkatëse të cilat rillogaritën.

Ky vendim, i eshte njoftuar "Shpallje publike", cate 22.01.2019, të cilit megjithëse i ka kaluar afati ligjor nuk ka ushtruar ndonje te drejte ankimi administrativ si edhe nuk ka likujduar shumën e borxhit doganor lindur sipas vendimit të sipërpërmendur.

Në këto kushte në bazë të vendimit të sipërpërmendur të Degës së Doganës Fier, me qëllim për rikuperimin me forcë të borxhit doganor të përcaktuar në Vendimin 89 date 25.06.2018 që debitori "Griselda Rushanaj" me ID I75827074M, ka ndaj Degës së Doganës Fier, në zbatim të nenit 280 të K.Doganor dhe nenit 511 e vijues të K.Pr.Civile

VENDOSA QË:

- 1.Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të cmuar, valutë të huaj të depozituara në bankë, që i përkasin debitorit, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- 2.Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme dhe të patundshme që i përkasin debitorit, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- 3.Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet e mundur plotësimi i detyrimeve të mësipërme në masën e përcaktuar në vendimin 89 date 25.06.2018 si dhe të kamatë vonesave të lindura në bazë të nenit 280 pika 1/b të Kodit Doganor deri në ditën e likuidimit të borxhit doganor.

LUAN HJESA

KRISTAR DEGES DOGANORE